

V E N D I M
Nr.610, datë 31.12.1993

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.452, DATË 16.9.1993 “PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.7703, DATË 11.5.1993 “PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në zbatim të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale dhe të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.452, datë 16.9.1993, paragrafi i parë i kreut II ndryshohet si vijon:

“Në zbatim të neneve 2, 32, 36, 48 dhe 54 niveli bazë për vitin 1994 është 1920 lekë.

2. Paragrafi i parë i kreut III dhe pika 1 ndryshohet si vijon:

“Në zbatim të neneve 9, 10, 13, 14 dhe 90 masat dhe kriteret e kontributeve minimale mujore për vitin 1994 janë :

1. Për degët e sigurimit:

- Dega e sigurimit të sëmundjeve 39 lekë

- Dega e sigurimit të barrë lindjes 71 lekë

- Dega e sigurimit të pensioneve 812 lekë

- Dega e sigurimit të aksidenteve dhe

sëmundjeve profesionale 13 lekë

- Dega e sigurimit të papunësisë 153 lekë

3. Pika 2 e kreut III ndryshohet si vijon:

“Për personat e punësuar, punëdhënësi derdh kontribut të detyrueshëm me masën 32.5 për qind të listpagesave mujore në kufijtë e pagës minimale mujore 2560 lekë dhe asaj maksimale 7680 lekë”.

4. Pas pikës 2 të kreut III shtohet pika 2/a me këtë përmbajtje:

“Për personat e punësuar punëdhënësi mban 3 për qind nga paga e tyre në kufijtë e pikës 2 dhe e derdh si kontribut të detyrueshëm së bashku me pjesën e tij”.

5. Në kreun III pika 3 ndryshohet si vijon:

“Personat e tjerë ekonomikisht aktive (punëdhënësi dhe të vetëpunësuar, duke përjashtuar të vetëpunësuarit në bujqësi) derdhin kontribut të detyrueshëm në masën 34.5 për qind të pagës minimale mujore 2560 lekë që i përgjigjet kontributi mujor minimal 883 lekë”.

6. Në kreun IV fjalët “çdo muaj” të zëvendësohen me fjalët “çdo gjashtë muaj”.

7. Në kreun VI, pika 1, pas fjalës “duhet” të shtohet shprehja “të regjistrohen si të papunë pranë zyrës së punës dhe...”.

8. Kreu VII ndryshohet si vijon:

“Personat që përfitojnë nga ligji nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, përfitojnë kompensim vetëm për personat që kanë në ngarkim në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.310, datë 24.7.1992, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.274, datë 12.6.1993”.

9. Kreu IX, paragrafi i parë dhe pika 1 ndryshohet si vijon:

“Efektet financiare për vitin 1994 janë:

1. Kontributi prej 10 për qind që duhet të derdhin të punësuarit, përballohet në masën 7 për qind nga buxheti i shtetit, i cili për vitin 1994 financon Institutin e Sigurimeve Shoqërore me 1.100 milionë lekë dhe 3 për qind nga të punësuarit”.

10. Kreu IX, pika 2 shprehja “me 640 milionë lekë” zëvendësohet me shprehjen “me 3.7. miliardë lekë”.

II. Në kreun IX pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“Shteti paguan kontribut për kohën që shtetasi kryen shërbimin e detyrueshëm ushtarak. Buxheti i shtetit për pagimin e këtij kontributi financon Institutin e Sigurimeve Shoqërore me 330

milione lekë”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga dat 1.1.1994.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi